



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË**

**BASHKIA E LEZHËS NË PARTNERITET ME PROGRAMIN ReLOaD 2 SHPALL:
“THIRRJEN E SHTATË PUBLIKE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE PËR
DORËZIMIN E PROJEKT PROPOZIMEVE”**

Qëllimi i përgjithshëm i programit ReLOaD është që të fuqizojë demokracitë pjesëmarrëse dhe procesin e integritimit në BE në Ballkanin Perëndimor, duke mbështetur Shoqërinë Civile që të jetë pjesë e proceseve të vendimmarrjes si dhe duke stimuluar dhe krijuar një mjedis ligjor dhe financiar inkurajues për të. Disa nga rezultatet që projekti ReLOaD do të arrijë janë:

- Bashkitë do të përdorin modele transparente dhe të bazuara në projekte konkrete përfinancimin e OSHC-ve;
- OSHC-të do të ofrojnë shërbime të cilat adresojnë nevojat e qytetarëve në bashkitë partnere dhe janë në zbatim të planeve dhe strategjive lokale për zhvillim;
- Kapacitete të fuqizuara të OSHC-ve dhe njësisive të pushtetit vendor për të zbatuar skemat e grantit dhe ofruar projekte cilësore;
- Përmirësimi i bashkëpunimit rajonal, dialogut, ndarjes së praktikave ndërmjet njësisive të pushtetit vendor dhe OSHC-ve në Ballkanin Perëndimor.

Për sa më sipër, **Bashkia e Lezhës** dhe programi **ReLOaD 2 fton** të gjitha **Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të)** në Shqipëri që të paraqesin projekt-propozime që janë në përputhje me objektivat zhvillimore dhe prioritetet e Bashkisë së Lezhës si më poshtë:

Prioritetet si më poshtë vijon:

1. Shtimi i shanseve integruese dhe rritja e kujdesit social dhe shëndetësor për të moshurit.
2. Fuqizim ekonomik për viktimat e Dhunës në Familje;
3. Rigjallërimi i jetës sociale dhe kulturore në zonat rurale, nëpërmjet organizimit të festave lokale.
4. Jetëzimi i shkollave si qendra komunitare duke i pasuruar me aktivitete sportive në zonat urbane dhe rurale.
5. Përfshirja e teknologjisë dhe inovacionit në promovimin e Lezhës dhe resurseve të saj.
6. Promovimi dhe nxitja e ndërgjegjësimit ndaj çështjeve të sigurisë, duke përfshirë edhe sigurinë kibernetike.
7. Krijimi i programeve edukative për të rinjtë që promovojnë trasgëgiminë kulturore dhe artin.
8. Bashkëpunimi me shkollat lokale për të integruar aktivitetet kulturore në kurrikulën shkollore.

9. Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit të Lezhë mbi ndarjen dhe menaxhimin e mbetjeve në burim.
10. Rritja e kapaciteteve të rinjve për pjesëmarrje aktive dhe përfitim nga programet që ofron Bashkimi Evropian.

Totali i grantit në Bashkinë e Lezhës për këtë Thirrje është: **4,000,000 Lekë.**

OSHC-të të cilat kanë qenë partnere dhe kanë zbatuar projekte në thirrjen e parë, të dytë, të tretë, të katërt pestë, dhe të gjashtë kanë të drejtë të aplikojnë, por vlera totale e grantit për të gjitha thirrjet nuk duhet të kalojë 5.000.000 ALL përfituar nga projektet e zbatuara në Bashkinë Lezhë.

Bashkia rezervon të drejtën të mos alokojë të gjitha fondet që ka në dispozicion në rast se projekt-propozimet e paraqitura nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara. Kohëzgjatja e propozuar e projektit të jetë më e shkurtër se 6 muaj ose më e gjatë se 8 muaj.

Kohëzgjatja e projekt-propozimit duhet të jetë nga 6 deri në 8 muaj.

PËRSHTATSHMËRIA/PRANUESHMËRIA:

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur, në baza të barabarta, për të gjitha OShC-të e regjistruara zyrtarisht (shoqata/organizata apo fondacion) në përputhje me ligjet dhe rregulloret e në fuqi në Shqipëri. **Të gjitha organizatat e Shoqërisë Civile të interesuara mund të gjejnë informacion të hollësishëm rreth kushteve për aplikim si dhe për kriteret për financimin e projekteve në Udhëzimin për Aplikantë (Shtojca 6), pjesë përbërëse e dokumentacionit të thirrjes publike.**

DOKUMENTACIONI:

Dokumentacioni për thirrjen publike për Bashkinë Lezhë mund të tërhiqet prej **08/07/2025 (dita e hapjes së Thirrjes Publike)** deri **08/08/2025 (dita e mbylljes së Thirrjes Publike)** duke e dërguar një kërkesë me emrin e organizatës së interesuar në e-mail adresën: projektetet.strategjike@lezha.gov.al apo personalisht, në adresën:

**DREJTORIA E PROJEKTEVE STRATEGJIKE, EVROPËS,
MIGRACIONIT, DIASPORËS, KOMUNIKIMIT DHE
TRANSPARENCËS , BASHKIA LEZHË**

KODI POSTAR 4501, SHESHI “GJERGJ KASTRIOTI”

Informacioni përkatës si dhe një version elektronik i të gjithë paketës së aplikimit mund të merret edhe nga faqja e internetit: <https://lezha.gov.al/>



DORËZIMI I APLIKIMEVE:

Aplikimet e plotësuara me të gjithë dokumentacionin, duhet të dorëzohen **në 3 (tre) kopje të shtypura dhe në një kopje elektronike (në CD apo USB)** përmes postës zyrtare apo personalisht, të vendosura në një zarf të vulosur që i referohet thirrjes publike, gjatë ditëve të punës (prej të hënës deri të premten), orarin zyrtar të Bashkisë Lezhë, në adresën:

**DREJTORIA E PROJEKTEVE STRATEGJIKE, EVROPËS, MIGRACIONIT,
DIASPORËS, KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS
BASHKIA LEZHË
KODI POSTAR 4501, SHESHI “GJERGJ KASTRIOTI”**

Afati përfundimtar për dorëzimin e aplikimeve është 08/08/2025 në orën 14:00. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të jenë shkruar emri i thirrjes publike për projekt- propozime, emri i plotë dhe adresa e aplikantit, emri i plotë i projektit në të cilin po aplikoni si dhe fjalët: **“Të mos hapet përpara hapjes zyrtare”**.

Me qëllim mbështetjen e OSHC-ve për të paraqitur aplikime në përputhje me kriteret e Udhëzuesit, bashkia do të organizojë takime informuese/ ditë të hapura:

1. Bashkia Lezhë do të organizojë një takim informues/ditë të hapur mbi Thirrjen e Shtatë Publike, ku ftohen të marin pjesë të gjitha organizatat e interesuara për të aplikuar në përgjigje të kësaj Thirrjeje. Ky takimi ka si qëllim, informimin e OSHC-ve mbi elementët kryesorë të Thirrjes, duke u fokusuar tek elementët më të rëndësishëm për OSHC-të. Për Bashkinë Lezhë takimi informues do të **organizohet më 18/07/2025.**
2. Pyetje rreth ftesës publike mund të behën përmes e-mail projektet.strategjike@lezha.gov.al duke iu referuar thirrjes publike. Pyetjet mund të dërgohen deri më më 1/08/2025, ndërsa përgjigjet do të jepen me shkrim brenda 5 ditëve pune që nga data e pranimit të pyetjeve përkatëse. Për qëllime transparence, përgjigjet mund t’u dërgohen gjithashtu të gjithë aplikantëve të mundshëm me email.